



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS  
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE, SHËRBIMEVE E STATISTIKËS**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.  
2023

Durrës, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .

**RAPORT MONITORIMI  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS**

**(01.Janar – 31 Dhjetor 2022)**

Detajimi i buxhetit për vitin 2022 bazuar në kërkesat e sektorëve apo dhe të ZVAP-eve në juridiksion për fondet e alokuara për vitin 2022 është realizuar në tre programe buxhetore ose nivele arsimore ku janë mbajtur parasysh objektivat, qëllimi i synuar, përfituesit, në synim të objektivave të realizimit të misionit të kryesor në që ka arsimit dhe legjislacionit në fuqi, objektivave të përcaktuara në strategjinë e arsimit parauniversitar.

**Zbatimi i buxhetit të shtetit, në përputhje me dispozitat ligjore. Realizimi i treguesve të buxhetit, analizimi dhe krahasimi me vitet e kaluara.**

*Drejtorja Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës ka punuar për të realizuar të gjitha objektivat e përcaktuara.*

*Veprimtaritë kryesore të realizuara gjatë kësaj periudhe si vijon:*

Pjesë e zbatimit e ”, Udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në Institucionet Arsimore Publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “ Mësues për Shqipërinë” për vitin 2022.

Inspektimi dhe kontrolli i organikave dhe zbatimi i kuadrit ligjor të Institucioneve Arsimore të ZVAP- ve në juridiksion të DRAP Durrës.

Realizoi vazhdimin e procedurës bazuar në Urdhërin Nr.313 Prot datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar

dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit nga shërbimi psiko-social”dhe emërimin. Për shërbimin psiko-social janë 61 emërimë.

Realizoi vazhdimin e procedurës së emërimit të oficerëve të sigurisë fitues sipas vendeve vakante të ardhura nga 12 ZVAP-et ne juridiksion dhe emërimin ose jo definitive pas periudhes së provës.

Realizoi vazhdimin e procedurës së emërimit të drejtorëve fitues sipas vendeve vakante të ardhura nga 12 ZVAP-et ne juridiksion dhe emërimin ose jo definitive pas periudhes së provës.

Realizoj prokurime per 12 ZVAP-et në juridiksion për fondin e bibliotekave të IPAP

*Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore, sipas tre programeve të miratuara, si më poshtë:*

**1. Planifikim menaxhim administrim**


**2. Arsimi Bazë**

**3. Arsimi Mesëm I Lartë**


**1.Realizimi i shpenzimeve sipas programeve buxhetore rezulton si më poshtë:**

		Plani i alokuar për 12 mujorin e parë 2022		Realizimi faktik për 12 mujorin e parë 2022	
		Në (000) Lekë	Në (%) ndaj buxhetit vjetor	Në (000) Lekë	Në (%) ndaj faktit
1110	Planifikim Menaxhim	190,978	1.49%	128,740	1.10%
9120	Arsimi Bazë	9,768,362	76.01%	8,941,800	76.61%
9230	Arsimi i Mesëm	2,891,992	22.50%	2,601,717	22.29%
	<b>TOTALI</b>	<b>12,851,331</b>	<b>100%</b>	<b>11,672,257</b>	<b>100%</b>

Plani i alokuar 2022 sipas programeve buxhetore



■ Planifikim Menaxhim ■ Arsimi Bazë ■ Arsimi i Mesëm




## 2.Pesha specifike e fondeve të alokuara në % sipas programeve për vitin 2022

Ko di	Emri	BUXHETI 2022	Perqindja qe ze ne buxhet
600	Paga	8,977,095	82.8%
601	Sigurime Shoqërore	1,532,837	14.1%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	316,362	2.9%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	3,061	0.03%
231	Kapitale të Trupëzuara	8600	0.1%

## 3.Fondet e alokuara sipas artikujve për vitin 2022

Artikulli	Përshkrimi	Plani 12-mujor	
		Në (000) Lekë	Në (%) ndaj planit 12-mujor
600	Paga personeli	10,201,502	79%
601	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	1,637,206	13%

602	Mallra dhe sherbime te tjera	415,136	3%
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	460,758	4%
231	Aktive afatgjata materiale	136,729	1%
	<b>TOTALI</b>	<b>12,851,331</b>	<b>100%</b>




#### 4.Fondet e alokuara në programin Planifikim Menaxhimi për vitin 2022

<b>Fondet e alokuara në programin Planifikim Menaxhimi për vitin 2022</b>		
Paga	<b>600</b>	10,201,502
Sigurime	<b>601</b>	1,637,206
Shpenz operative	<b>602</b>	415,136
Trans. Per Buxh. Fam. & Individ	<b>606</b>	460,758
	<b>TOTALI</b>	<b>12,851,331</b>

#### 5.Realizimi faktik në programin Planifikim Menaxhimi për vitin 2022

<b>Artikulli</b>		<b>Fakti 12-mujori pare 2022</b>
600	Paga personeli	9,108,627

601	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	1,569,396
602	Mallra dhe sherbime te tjera	436,045
602	Subvencione	13,882
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	537,382
	<b>Shpenzime korrente</b>	<b>11,665,332</b>



**6.Pesha specifike e realizimit te buxhetit krahasuar me planin e alokuar sipas programeve për vitin 2022**


Program	Përshkrimi	Plani viti 2022	Fakti viti 2022	Realizimi në (%) ndaj buxhetit
		në (000) Lekë	në (000) Lekë	
1110	Planifikim Menaxhim	190,978	128,740	67.41%

9120	Arsimi Bazë	9,768,362	8,941,800	91.53%
9230	Arsimi Mesëm I Lartë	2,891,992	2,601,717	89.96%
	<b>TOTALI</b>	<b>12,851,331</b>	<b>11,672,257</b>	<b>90.82%</b>

Shpenzimet për vitin 2022 paraqiten si më poshtë

Nr.	Përshkrimi	Fakti
1	Internet	43,200
2	Dieta	407,060
3	Kancelari	120,000
4	Vula	1,800
5	Siguracion TPL	18,705
6	Taksa makine	11,458
7	Transprt nxenes shkolla B.Qerraxhia	391,250
8	Dieta Matura Shteterore	79,020
9	Riparim makine	58,680
10	Tonera	55,100
	<b>TOTALI</b>	<b>1,186,273</b>

Më poshtë po paraqesim parashikimin e perdorimit te fondeve buxhetore per shpenzime operative për DRAP Durrës për vitin 2022




**7-Fondet e shpërndarë për vitin 2022 sipas ZVA-ve dhe DRAP-it .**

<b>DRAP Durrës</b>	<b>Plani I alokuar DRAP+12 ZVAP-e për vitin 2022 vjetor</b>	<b>Faktiku I realizimit DRAP+12 ZVAP-e për periudhën 12 mujori 2022</b>
DRAP Durrës	174,916	23,794
ZVAP Krujë	722,427	687,579
ZVAP Bulqizë	399,184	368,210
ZVAP Tiranë	5,373,732	5,065,299
ZVAP Rrogozhinë	267,002	264,941
ZVAP Kavajë	603,451	447,373
ZVAP Durrës	2,015,595	1,750,345
ZVAP Mat	405,390	356,457
ZVAP Vorë	381,137	333,278
ZVAP Kamëz	1,138,434	1,056,968
ZVAP Shijak	233,231	242,215
ZVAP Dibër	852,832	822,740
ZVAP Klos	284,000	253,057
<b>T O T A L I</b>	<b>12,851,331</b>	<b>11,672,256</b>


### Plani i alokuar DRAP + 12 ZVAP

- DRAP Durrës
- ZVAP Krujë
- ZVAP Bulqizë
- ZVAP Tiranë
- ZVAP Rrogozhinë
- ZVAP Kavajë
- ZVAP Durrës
- ZVAP Mat
- ZVAP Vorë
- ZVAP Kamëz
- ZVAP Shijak
- ZVAP Dibër
- ZVAP Klos




### Faktiku i realizimit per DRAP dhe ZVAP

- DRAP Durrës
- ZVAP Krujë
- ZVAP Bulqizë
- ZVAP Tiranë
- ZVAP Rrogozhinë
- ZVAP Kavajë
- ZVAP Durrës
- ZVAP Mat
- ZVAP Vorë
- ZVAP Kamëz
- ZVAP Shijak
- ZVAP Dibër
- ZVAP Klos



### 8–Totali i IPAP sipas ZVA-ve në varësi.

	DRAP Durrës	TOTALI IPAP
1	ZVA MAT	12
2	ZVA KLOS	11
3	ZVA VORE	13
4	ZVA RROGOZHINE	11
5	ZVA KAMEZ	23





<b>6</b>	<b>ZVA KAVAJE</b>	<b>18</b>
<b>7</b>	<b>ZVA DIBER</b>	<b>38</b>
<b>8</b>	<b>ZVA KRUIJE</b>	<b>26</b>
<b>9</b>	<b>ZVA TIRANE</b>	<b>140</b>
<b>10</b>	<b>ZVA SHIJAK</b>	<b>14</b>
<b>11</b>	<b>ZVA DURRES</b>	<b>55</b>
<b>12</b>	<b>ZVA BULQIZE</b>	<b>17</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>378</b>

Për vitin 2022 përfituan Subvencion të teksteve shkollore nxënës në Arsimin Bazë dhe në Arsimin e Mesëm të Lartë me një fond prej 13,884 ne 000/leke.

Transporti i nxënësve dhe mësuesve bazuar në VKM-në nr.682 datë 29.07.20215 “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit” të ndryshuar gjatë vitit 2022 përfituan këtë shërbim 954 përfitues me një fond prej 105,910 ne 000/lekë.

	<b>2022</b>
<b>Nr. Përfituesve</b>	954
<b>Fondi I perdorur</b>	105,910

#### PROBLEMATIKA:

Vështirësi në prokurimin e këtij shërbimi.


Mungesë konkurrence dhe oferte nga operatorët ekonomik.

Vështirësi në zbatimin e VKM-së nr.682 datë 29.7.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit” të ndryshuar.

Staf i pa trajnuar sidomos për prokurim të tillë kaq specifik si për kushtet e përcaktimit të saktë të përfituesve apo dhe vëtespecifikimet teknike për realizimin e këtij prokurimi.

**Fondi i bibliotekave:** Për vitin 2022 është vijuar me prokurimin për prokurimin e librit artistik për 70 IPAP, me një fond prej 8,600 ne 000/leke, 58.6% me shumë në vlerë, krahasuar me vitin 2021 që kishte fond me vlerë 5,045 ne 000/lekë.

	<b><i>Fondi ne dispozicion në 000/lekë</i></b>
<b><i>Biblioteka 2021</i></b>	5,045
<b><i>Biblioteka 2022</i></b>	8,600



Gjate Vitit 2022 proceduara e trajnimit nuk është vijuar. Për vitin 2023 është planifikuar të vijohet me trajnime te punonjësve mësimorë, gjithashtu dhe me trajnimin e personelit te DRAP-it.

IPAP-të e ZVAP-eve në varësi janë pajisur me **834 laptopë Lenovo**.

DRAP, bashkë me ZVAP-et në varësi janë pajisur me **936 kompjuter+desktop HP**.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2022, për anën juridike dhe financiare , zyrat janë asistuar në realizimin e objektivave për ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit si dhe nga ana financiare pas hartimit te gjurmëve të auditit për këto procedura, për vijimin e menjëhershëm të likuidimit të detyrimeve.

Janë punësuar në vende vakante definitive 365 fitues nga Portali “Mësues për Shqipërinë” ose punësime jashtë portalit sipas renditjes dhe 1626 punësime në vendet provizore me fitues nga Portali Mësues për Shqipërinë, ose punësime jashtë portalit.

Lidhur me shërbimin psiko-social DRAP Durrës në zbatim të urhdërit nr.313 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social” ka punësuar gjatë vitit 2022, 119 punonjës.

Në vitin 2022 numri i mësuesve ndihmës ishte 483 punonjës mësimor. Numri i nxënësve me aftësi të kufizuar ishte 1621.

### **Spektori i Burimeve Njerëzore Shërbimeve dhe Statistikës në DARP dhe sektori i Shërbimeve në ZVAP , për 12 mujorin e 2022 ka realizuar detyra si më poshtë:**

Hartimin e shpërndarjes së fondeve të buxhetit të shtetit për vitin ,të miratuara me ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2022”, bazuar në kërkesat e sektorëve në realizim të detyrave funksionale.

Hartimin dhe realizimin e rregjistrimit të parashikimeve të prokurimeve publike për fondet e alokuara për vitin 2022

Përgatitja e raportit të **monitorimi të konsoliduar**, të zbatimit të buxhetit për vitin 2022, së bashku me anekset e monitorimit për vitin 2022 të DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-et në juridiksion për periudhën Janar – Dhjetor 2022

Përgatitja e një përmbledhëse vjetore të **Pasqyrave Financiare për vitin 2022** bazuar në PF të 12 ZVAP+DRAP dhe evidentimi i problematikave .

**Përgatitja e Deklaratës Vjetore** “Për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë për vitin 2022”. Plotësimi i Pyetësorit të vetëvlerësimit për vitin 2022(pyetjeve të pyetësorit sipas komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (Neni 19, i Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar).  
Bashkëpunimin në hartimin e regjistrit të Riskut për DRAP Durrës2022

Raportime në MASR për **detyrimet/ borxhet e krijuara rishtazi për vitin 2022**.  
Analizë dhe përgatitje e shkresave sipas problematikave të konstatuara.

Analizë ,përgatitje e autorizimeve dhe likujdimin e shpenzimeve për udhëtime e dieta të punonjësve konform vendimeve të Këshillit të Ministrave;

Analizë dhe përgatitje e shkresave për fonde për pagesën nga fondi i vecantë të punonjësve të sistemit arsimor konform vendimeve të Këshillit të Ministrave drejtuar MASR dhe likujdimi i tyre nga ana e ZVAP -e;

Monitorimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në institucionet e vartësisë,për punonjësit ndihmës dhe shërbimit psiko-social.

Raportimi mujor i punonjësve që mbushin moshën për pension për DRAP+12 ZVAP.  
Përditësimi i data bazës së punonjësve dosjet elektronike te punonjësve DRAP dhe ndjekja e ZVAP-eve

Ndjekja e procedurave për emërim apo komandim të përkohshëm të drejtuesve të IA,në zbatim të Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar” ,të ndryshuar ,Punonjës të shërbimit psiko-social dh oficerët e sigurisë.

Marrja e informacionit nga të gjitha IA për numrin e nxënësve, klasave, personelit mësimor .  
Për periudhën Janar-Dhjetor 2022, janë përgatitur/hartuar dokumentacionin ligjor të përfaqësimit të DRAP ,MAR.DPAP, si autorizime, prapësime, ankime, kundërankime, për çështjet gjyqësore në të cilët ka qenë palë ndërgjyqëse në vitin 2022, si dhe ankimet/kundërankimet dhe rekurset/kundërrekurset për çështjet të ndjekura para vitit 2022. Në kuadër të përgatitjes së prapësimeve, sektori ka bashkëpunuar dhe me njësi të tjera në ZVAP

Sektori ka administruar dosjen e çdo çështjeje gjyqësore të ngritur në vitin 2022-2022, si dhe ka plotësuar në vijimësi të ecurisë gjyqësore të çështjeve të administruara pranë tij, gjithë dokumentacionin që i përket secilës çështje, si vendimin gjyqësor përkatës, ankimin/kunderankimin, rekursin/ kundërrekursin, si dhe dokumentet/akte të tjera të depozituar në cilësinë e provës.

Sektori ka përfaqësuar dhe vijon përfaqësimin e DRAP në seancat gjyqësore për të gjitha çështjet ku është palë ndërgjyqëse,dhe MAS M dhe DPAP në zbatim të autorizimeve përkatëse.  
Analiza vjetore sektori i inspektimit dhe

vlerësimit të cilësisë për periudhën Janar- Dhjetor 2022.

Spektori i Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë në DRAP Durrës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, në zbatim të Ligjit 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr.99, datë 27.02.2019 " Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar " Urdhërit Nr.68, datë 05.04.2019, për "Miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar", "Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar" me nr.4699/1 prot, datë,30.04.2019, ka kryer inspektime në institucionet arsimore parauniversitare dhe 12 ZVAP-të në juridiksion të DRAP Durrës. Spektori i Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë në DRAP Durrës në zbatim të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar ka kryer në kohë dhe sipas rastit:

Inspektime, monitorime, vlerësime, ka nxjerr përfundime dhe rekomandime për zbatueshmërinë e kriterëve të ligjshmërisë nga institucionet arsimore parauniversitare publike dhe ZVAP-të. Monitorime me synim, verifikimin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në institucionet arsimore parauniversitare dhe në ZVAP-të përkatëse Propozime dhe masa sipas gjetjeve të inspektimit si dhe verifikimin e zbatimit të tyre nga ZVAP-të dhe institucionet arsimore përkatëse.

Inspektime për cilësinë e zbatimit të Rregullores së Maturës Shtetërore.

Monitorime për shpërndarjes dhe pajisjen me tekste të nxënësve.

Monitorime për zbatueshmërinë e akteve normative për regjistrimin e nxënësve. Vlerësime të institucioneve arsimore për fushën” Drejtim dhe menaxhim”.

Trajtimi i ankesave të qytetarëve të deleguara nga portal i “Bashkëqeverisjes me qytetarët” dhe MAS, DPAP.

Theksojmë se qëllimi i inspektimeve, të realizuara, ka qenë dhe është jo vetëm verifikimi i funksionimit të IA-ve dhe ZVAP-ve, në raport me zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, por ndikim në cilësinë e arritjeve të shkollës. Konkretisht inspektimet me natyrë vlerësimin e cilësisë së shërbimit arsimor nga SIVC në DRAP Durrës janë orientuar jo vetëm nga plani vjetor dhe ai gjashtë mujor, por dhe nga ASCAP, DPAP si dhe problematikat e diktuar nga portali i “Bashkëqeverisjes me Qytetarët”.

Bashkëpunimi me ASCAP dhe DPAP, për vlerësimin e institucioneve arsimore parauniversitare në rajonin e Korçës, Gjirokastrës, Lezhës dhe Durrësit, kanë ndikuar në drejtim të cilësisë së menaxhimit të shkollave si dhe ka ndihmuar specialistët e këtij sektori për standardizimin e vlerësimit të IA-ve. Theksojmë se inspektimet tematike, me qëllim vlerësimi, janë mbështetur në Metodologjinë e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të IA-ve si dhe në zbatim të udhëzimeve të MSH dhe MAS. SIVC ka kryer 56 monitorime dhe 26 inspektime tematike dhe të orientuara. 20 inspektimet tematike janë kryer në fushën “Drejtimi dhe menaxhimi”, ndërsa 6 inspektimet e orientuara kanë patur qëllim vlerësimin e ankesave të qytetarëve, të deleguara nga MAS dhe DPAP sipas grafikut me poshte.

# GRAFIKU I INSPEKTIMEVE

## INSPEKTIVE SIVC 2021-2022

Inspektive	Nr
Monitorime	56
Inspektive tematike dhe të orientuara	20
Inspektive të orientuara, ankesa nga qytetarët	6
<b>Inspektive Totale</b>	<b>82</b>

## INSPEKTIVE SIVC 2021-2022



Monitorimet e kryera në IA-të dhe ZVAP-të janë orientuar për:

Masat e marra nga ZVAP-të për zbatimin e udhëzimeve të MAS për fillimin e vitit të ri shkollor në IAP.

Masat e marra nga IA-të për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore. Specialistët e SIVC në DRAP kanë vlerësuar treguesit që kanë të bëjnë me hartimin e dokumentave kryesor për funksionimin e IA-ve; planin afatmesëm, planin vjetor të shkollës, rregullorja e brendshme, mënyra e monitorimit dhe dokumentimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës. Bashkëpunimi i shkollës me aktorët dhe faktorët që janë përfitues të shërbimit arsimor ose të interesuar për cilësinë e shërbimit të ofruar, si dhe shërbimi psiko-social.

Vlerësohet fakti se Sektori i Inspektimit ka dalë me përfundime, ka dhënë rekomandime dhe ka verifikuar zbatueshmërinë e tyre për IA-të, me synim përmirësimin e menaxhimit të brendshëm të shkollës. Vlerësimet dhe monitorimet e realizuara janë orientuar, nga qëllimi, për të ndihmuar dhe ndikuar në përmirësimin e menaxhimit të brendshëm të institucioneve arsimore dhe ZVAP-ve. Bashkëpunimi ndërinstytucional ka qenë parimi bazë për verifikimin e realizimit të treguesve në shkolla.

Theksojmë se ky sektor nuk është mjaftuar vetëm në identifikimin e problematikave që lidhen me zbatimin e udhëzimeve të MAS, por dhe në përmirësimin e veprimtarisë së stafëve drejtues dhe punës mësimore-edukative në shkolla.

SIVC, me qëllim ndikim në cilësinë e shërbimit arsimor në IA-të, e vlerësuar dhe monitoruar, ka hartuar raporte me gjetje/gjykime, përfundime, rekomandime dhe afate për përmirësim.

Konkretisht janë dhënë këto rekomandime: Drejtoritë e shkollave të hartojnë Rregulloren e brendshme të institucioneve arsimore, në përputhje me udhëzimin e MASR-së Nr. 30, datë 02.08.2013 “ Për rregulloren tip të institucioneve arsimore”

Në zbatim të Udhëzimit të MASR-së Nr.25, datë 25.07.2018 ” Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”, të ngrihet bordi i institucionit arsimor.

Të zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore për ngritjen dhe funksionimin e “Këshillave të Prindërve”, “Qeverisë së Nxënësve”, “Komisioni i Etikës dhe Sjelljes” dhe “Komisionin e Disiplinës” në shkollë. Drejtuesit e shkollës të ngrenë grupet e punës për ndryshimet e domosdoshme në planin afatmesëm dhe planin vjetor të shkollës në përputhje me nenin 49,50,51,52 dhe 53, të Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 të MASR-së . Sigurimi i teksteve shkollorë që mungojnë. Drejtorët e IA-ve, në zbatim të nenit 49, pika 7, e

“Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me urdhrin nr.31, datë 28.01.2020 të MASR-së, të ngrenë një grup te posaçëm pune, i cili të vëzhgoj zbatimin e planit afatmesëm dhe t’i raportoj me shkrim çdo gjashtë muaj drejtorit lidhur me ecurinë e zbatimit të planit afatmesëm . Drejtuesit e shkollave të marrin masat e nevojshme për fillimin e procesit të vlerësimit të brendshëm në përputhje me nenin 54, të “Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 dhe “Metodologjisë së vlerësimit të brendshëm të shkollës”, ASCAP 2020. Drejtuesit e IA-ve të hartojnë menjëherë planin për zhvillimin e brendshëm profesional, sipas nevojave reale të stafit, dhe ta zbatojnë, atë, në përputhje me pikën 1, të nenit 45, të “Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 të MASR-së. Në zbatim të nenit 62, kreu XII, të “Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 të MASR-së drejtorët e shkollave të realizojnë vlerësimin e mësuesit bazuar në “Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm lëndor të mësuesit në AMU”, miratuar me Urdhër të MASR-së Nr.246, datë 24.07.2020. Në zbatim të Urdhërave të MASR-së; Nr.267, datë 15. 05, 2018 ” Për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollorë të klasave 1 dhe 6- 12 në sistemin arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2018-2019”, Nr.106, datë 30.04.2020” Për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollorë të klasave 1 dhe 6- 12 në sistemin arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2020-2021”, drejtoritë e shkollave në bashkëpunim me botuesit dhe distributorët të marrin masa për plotësimin e nevojave të nxënësve me tekste shkollor. Drejtuesit e IA-ve, të realizojnë orët e kontrollit duke përdorur formate standarde, për vlerësimin e procesit të mësimdhënies/nxënies dhe të plotësimit të dokumentacionit shkollor, si dhe të hartojnë raporte, dhe të kryejnë analiza me këshillin e mësuesve.

Mësuesit gjatë orës mësimore të përdorin metoda, teknika, si dhe strategji ndërvepruese, për një proces didaktik krijues, në përshtatje të nevojave dhe mundësive të të gjithë nxënësve. Në zbatim të nenit 49,50,51,52,53 pika 6 e “Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 të MASR-së, ZVAP-të të miratojnë ndryshimet e domosdoshme për planin afatmesëm dhe planin vjetor të shkollës .

ZVAP-të të monitorojnë në vijimësi realizimin e rekomandimeve të dhëna për drejtoritë e shkollave.

Theksojmë faktin se në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, që rregullojnë funksionimin e IA- ve, janë propozuar për 18 drejtues shkollash masa disiplinore.

### *Sektori i kurrikulës dhe zhvillimit profesional*

Sektori së bashku me specialistët e kurrikulës kanë ndjekur trajnime kualifikuese të zhvilluara nga MAS, ASCAP apo agjensitë e ndryshme si dhe pjesë e projekteve të zhvilluara nga organizata dhe shoqata që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në fushën e edukimit si p.sh: SAVE THE CHILDREN, UNICEF, Eorld Vision etj. Duke u mbështetur në ecurinë e sektorit në vitin e kaluar dhe duke marrë parasysh problemet dhe ndryshimet në arsimin parauniversitar për vitin 2021, u hartua plani i punës në të cilin u përcaktuan SYNIMET, OBJEKTIVAT dhe VEPRIMTARITË me anën e të cilave do të mundësohej realizimi i detyrave të Sektorit dhe plotësimi i kërkesave që dalin nga zbatimi i Ligjit 69/2012 të Arsimit Parauniversitar, Rregullores, Urdhrit Nr.31, datë 28.01.2020 për Miratimin e rregullores për funksionimin e Institucioneve Arsimore të Arsimit Parauniversitar në RSH, Rregullores për funksionimin e Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar si dhe udhëzimeve dhe vendimeve të MAS. Funksionimi dhe mbarëvajtja e IAP-ve në varësi është përgjegjësi e DRAP dhe ZVAP. Gjithashtu përgjegjësia e institucionit tonë në bashkëpunim me Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar është të sigurohet zbatimi i kurrikulës, metodologjisë dhe standardeve, të vlerësohen nevojat dhe problematikat, të propozohen zgjidhje, të monitorohet kualifikimi i personelit mësimor për kurrikulën, të garantohet ngritja e rrjeteve profesionale, rekrutimi i mësuesve sipas kriterëve të përcaktuara në ligjet dhe udhëzimet e MAS.



## Objektivat e punës për vitin 2022

Sektori i Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional pranë Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) Durrës, mbështetur në detyrat e përcaktuara në VKM Nr. 99, datë 27.02.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar”, përcaktoi për vitin 2021, objektivat e mëposhtme:

Objektivi i parë – Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar

Objektivi i dytë – Zhvillimi profesional i mësuesve

Objektivi i tretë – Zbatimi i akteve nënligjore dhe udhëzimeve të Ministrit për ZVAP dhe IAP

Objektivi i katërt – Mbështetja e ZVAP dhe IAP për zhvillimin e kurrikulës

Për secilin prej këtyre objektiva, janë përcaktuar veprimtari për të cilat, në vijim të këtij raporti do të paraqiten rezultatet e përgjithshme, arritjet, problemet dhe sfidat për vitin në vijim.

# OBJEKTIVI I PARË

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2021-2025

*Veprimtaritë për realizimin e objektivit*

**Një nga sfidat e implementimit të kësaj kurrikule siç parashikohet edhe në Strategjinë Kombëtare**, vazhdon të mbetet sigurimi i infrastrukturës që ofron mundësi në përdorimin dhe përmbajtjen digjitale të procesit mësimor. Për këtë është treguar kujdes në aftësimin e personelit mësimor në përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie duke ofruar trajnime të vazhdueshme Qëllimi i



përgjithshëm i SZhAPU-së është të sigurojë gjithëpërfshirjen dhe qasjen e barabartë në arsimin për të gjithë. Në kontekstin e modernizimit të sistemit të saj arsimor, Shqipëria po krijon një program për gjithëpërfshirjen sociale dhe po bën përpjekje për përmirësimin e arritjeve të nxënësve në të gjitha nivelet, për shembull, nëpërmjet zhvillimit të kurrikulës së bazuar në kompetenca, zgjerimit të përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në arsim dhe rikonceptimit të formimit të mësuesve

Unifikimi i platformave të mësimin online, pajisja me infrastrukturë hardëare tablet, PC, SMARTLAB ku janë 100 shkolla që janë pajisur me këto laboratore, projektet me StartUp-et, projektet e Kodimit ku janë përfshirë 60 shkolla të DRAP Durrës, janë disa nga masat e marra në përmbushje të realizimit të objektivave dhe treguesve matës që institucionet arsimore kanë për të konkuruar mes tyre me anë të Kartës së Performancës.

Në kuadër të projektit të kodimit si pjesë e kurrikulës së klasës së parë, sipas urdhërit të kryeministrit, Nr.151 datë 30.11.2021 “Për ngritjen e grupit ndërinstitutional të punës”, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar ka qenë pjesë e këtij grupi pune. Kushtet dhe kriteret që duhet të plotësonin shkollat për të qenë pjesë e këtij projekti janë si më poshtë:

Të kenë kushte të mira infrastrukturore (energji elektrike, klasa të pajisura me tavolina dhe karrige në gjendje të mirë, ngrohje, dyer të sigurta, lidhje interneti)

Të kenë të paktën 3 klasa paralele: të para, të dyta dhe të treta

Të kenë minimumi një mësues i profilit TIK.

Mundësisht të ketë kabinet informatike në gjendje të mirë.

Për pikat e mësipërme u mbledh informacion nga të gjitha shkollat. Në Shkurt 2022 është mbledhur informacion për të evidentuar 100 shkolla publike ku mund të zbatohet projekti si fazë e parë. Informacioni i kërkuar nuk u kufizua vetëm në pikat e mësipërme por u zgjeruar edhe për numrin e mësuesve që japin mësim, numrin e nxënësve gjithsej i ndarë sipas klasave, gjendjen dhe numrin e kabineteve të informatikës si dhe shtrirjen e shkollave sipas zyrave arsimore.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet shpërndarja sipas zyrave e IAP-ve që ka çdo ZVAP

<b>ZVAP</b>	<b>NR I IA SMARTLAB</b>
Bulqizë	2
Dibër	6
Durrës	21
Kamëz	11
Kavajë	5
Krujë	2
Klos	0
Mat	2
Shijak	2
Rrogozhinë	2
Tiranë	44
Vorë	3

## **ECURIA E NISMËS “SHKOLLA SI QENDËR KOMUNITARE”**

Nisma “Shkolla si Qendër Komunitare”, filloi zbatimin e saj në vitin 2014 dhe prej asaj kohe deri tani ka pasur një rritje të interesit të shkollave për t’u bërë pjesë në këtë nismë. Shkolla Qendër Komunitare (ShQK) është një model promovues dhe zhvillues për ta kthyer shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpunohet për zhvillimin e potencialit të plotë të çdo nxënësi.

Në vitin 2022, në DRAP Durrës , funksionuan 131 Shkolla si Qendër Komunitare (SHQK).

- 34.2%** në arsimin e mesëm të lartë (AML)
- 65.7%** në arsimin e mesëm të ulët (AMU)
- 62.8%** në qytet
- 37.2%** në fshat
- 17711** nxënës janë përfitues të veprimtarive dhe shërbimit që ofrohet në këto shkolla
- 30890** prindër të nxënësve të shkollës janë përfitues nga shërbimet në këto shkolla
- 354** mësues ofrojnë shërbimin dhe janë përfitues në këto shkolla

Tabela e mëposhtme tregon ecurinë tashmë disavjeçare të kësaj nisme me të dhënat për të gjitha vitet sipas treguesve. Në vitin 2021-2022, në DRAP Durrës , funksionojnë 131 Shkolla si Qendër Komunitare (SHQK). Të gjithë partnerët dhe aktorët e SHQK por në veçanti shkollat duhet të punojnë duke u udhëhequr fort nga *parimi që të kemi shkolla qendër komunitare dhe jo thjesht të flasim për Shkolla Qendër Komunitare.*

Në procesin e vlerësimit të standardeve të shkollës si qendër komunitare, familjet dhe komuniteti punojnë së bashku:

për të ndërtuar strategji të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për fëmijët, të rinjtë dhe familjet;  
 për të pasuruar dhe nxitur të nxënin përmes veprimtarive formale dhe joformale;  
 për të siguruar një mjedis që ofron dhe integron shërbime, të cilat aftësojnë për jetën, për shkollën familjen dhe komunitet.

<b>NUMRI I SHKOLLAVE QENDËR KOMUNITARE 2022-2023</b>			
<b>DRAP</b>		<b>2021-2022</b>	<b>2022-2023</b>
DURRËS	TOTAL-SHKOLLA QENDER KOMUNITARE(SHQK)	<b>115</b>	<b>131</b>
<b>DURRËS</b>	<b>SHQK-AML</b>	<b>31</b>	<b>38</b>
DURRËS	SHQK -AML QYTET	<b>20</b>	<b>25</b>
DURRËS	SHQK -AML FSHAT	<b>11</b>	<b>13</b>
<b>DURRËS</b>	<b>SHQK-AMU</b>	<b>84</b>	<b>93</b>
DURRËS	SHQK -AMU ZONE QYTET	<b>41</b>	<b>41</b>
DURRËS	SHQK -AMU ZONE FSHAT	<b>43</b>	<b>52</b>

<b>DRAP DURRËS PËRFITUES FËMIJË</b>			
<b>NXËNËS</b>	<b>Femër</b>	<b>Mashkull</b>	<b>Total</b>
<b>Nxënës me AK</b>	<b>80</b>	<b>178</b>	<b>258</b>

<b>Nxënës nga komuniteti rom&amp;egjyptian</b>	<b>152</b>	<b>170</b>	<b>322</b>
<b>Nxënës të tjerë</b>	<b>7961</b>	<b>6671</b>	<b>14632</b>
<b>Total</b>	<b>8193</b>	<b>7019</b>	<b>15212</b>

Fusha në të cilat janë fokusuar veprimtaritë e shkollave dhe përfshirja e komuniteteve në to, prezantohen në tabelën e mëposhtme.

<b>FUSHAT</b>
<b>FUSHA:1. Sigurimi i arsimit cilësor për çdo nxënës</b>
<b>FUSHA:2. Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve</b>
<b>FUSHA:3. Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit</b>
<b>FUSHA:5. Gjithëpërfshirja dhe respektimi i diversitetit</b>

**Cilat ishin ndikimet pozitive të “ Shkollës qendër komunitare” tek:**

**Prindërit:**

Përfshihen personalisht në aktivitetet e fëmijëve dhe vlerësojnë talentin e tyre nga afër.

Informohen në mënyrë të vazhdueshme për arritjet e gjithanshme të fëmijëve.

Bashkëpunojnë me stafin e shkollës për të njohur stilet e të nxënësve.

**Nxënësit:**

Zhvillohet shpirti human i nxënësve.

Informohen rreth zhvillimeve sociale të ndryshme të komunitetit.

Përfaqësojnë në mënyrë dinjitoze shkollën dhe veten në aktivitete sportive.

Shpalosin talentin e tyre.

Motivohen për të arritur suksesin e dëshiruar.

Ky proces ka ushqyer të qenit bashkëpunues dhe bashkëpunues në realizimin e detyrave.

Shumë nga veprimtaritë kanë ndihmuar nxënësit për të përmirësuar rezultatet e tyre, kryesisht nxënësit me vështirësi në të nxënë.

**Komuniteti:**

Aktivitetet sportive, kulturore dhe argëtuese kanë gjallëruar jetën e komunitetit.

Veprimtari me fokus mjedisin kanë ndihmuar në përmirësimin e kushteve ku ata jetojnë .

Në imazhin e institucionit arsimor ndjehet impakti i marrëdhënies shkollë – komunitet .

Idetë dhe angazhimi i komunitetit ka ndihmuar shkollën për të patur më të qartë krijimin e një shkolle vizionare

Shkolla ofron ndihma për komunitetin.

Nxënësit rrisin shpirtin e bashkëpunimit me komunitetin.

Komuniteti jep ide për rritjen e performancës së nxënësve.

### **Sfidat për të ardhmen**

Rritja e numrit të nxënësve dhe prindërve pjesëmarrës në veprimtaritë e “ Shkollës Qendër Komunitare”

Ndërtimi i një imazhi të besueshëm dhe të vlerësuar nga komuniteti me qëllim përfshirjen më të madhe të tij.

Ndërgjegjësimi me i madh i komunitetit për të mbështetur aktivitetet të organizuara nga SHQK. Gjetja e donatorëve apo sigurimi i mbështetjes nga OJF në implementimin e projekteve.

Më shumë pjesëmarrës dhe aktivitete.

Zhvillimi i procesit mësimor-edukativ në një shkollë tjetër dhe në turnin e pasdites.

Mungesa e mjediseve fizike.

Probleme me bazën materiale digjitale të IT dhe internetit në shkolle.

Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit, duke ofruar kurse, shërbime dhe mjedise fizike.

Nisur nga investimet e bëra në mjediset fizike të shkollave (ndikuar edhe nga problemet e krijuara nga tërmeti i Nëntorit 2019) ka patur kërkesa nga ZVAP-të që të shtohen shkolla të reja në nismën SHQK. Për këtë po punohet në mënyrë që të vlerësohen shkollat të cilat plotësojnë standartet sipas formularit të treguesve të shkollave SHQK dhe me marrjen e miratimit të MAS natyrisht do të kemi një numër të shtuar të tyre për vitin mësimor 2022-2023. Ky vlerësim është bërë dhe tashmë numri i shkollave SHQK për DRAP DURRËS është 131 shkolla

Puna jonë do të fokusohet në ndjekjen e veprimtarisë së shkollave SHQK me qëllim unifikimin e mënyrës së planifikimit sipas fushave, hartimit të veprimtarive të SHQK në përputhje me kushtet e shkollës, raportimit të realizimeve dhe përmbushjes së objektivave. Për këtë janë bërë trajnime me të gjithë koordinatorët SHQK të shkollave dhe ZVAP-ve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

### **PROVIMI I SHTETIT PËR PROFESIONIN E RREGULLUAR TË MËSUESIT 2022**

Në vitin 2022, një ndër veprimtaritë në lidhje me çertifikimin e mësuesve për ushtrimin e profesionit, ka qenë edhe procedura për regjistrimin e tyre për dhënien e provimit të shtetit. Në zbatim të shkresës nr.1451, datë 03.03.2022, "Për zhvillimin e provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit", gjatë muajit mars u regjistruan për të dhënë provimin e shtetit **1426** kandidatë nga të gjitha ZVAP në varësi të DRAP DURRËS. Më poshtë jepet tabela me rezultatet e ardhura nga QSHA pas përfundimit të provimit sipas profileve.

Nr.	Profili	Të rregjistruar	Pjesëmarrës	Kalues	Jokalues	Mungesa	Nota mesatare	Kalueshëria në %
1	Arsim fillor	271	215	80	135	56	4.8	37
2	Arsim special	91	86	83	3	5	6.9	96.5

3	Arte Figurative	13	8	6	2	5	5.6	75
4	Biologji	36	25	25	0	11	7.56	100
5	Biologji Kimi	44	27	9	18	17	4.7	33
6	Edukim Fizik	146	122	101	21	24	6.5	83
7	Fizikë	42	32	14	18	10	5.3	44
8	Gjeografi	85	64	43	21	19	6.4	67
9	Gjuhë Angleze	157	130	118	12	27	6.7	90
10	Gjuhë Frënge	22	21	13	8	1	5.7	62
11	Gjuhë Gjermane	16	13	5	8	3	4.8	38
12	Gjuhë Italiane	32	23	13	10	9	5.3	57
13	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	161	130	103	27	31	6.5	79
14	Gjuhë Turke	1	0	0	0	1	0	0
15	Histori	86	69	50	19	17	6.5	72
16	Histori-Gjeografi	26	17	9	8	9	5.3	53
17	Histori-Gjeografi-Edukatë	6	6	3	3	0	5.6	50
18	Informatikë	10	8	5	3	2	5.4	62
19	Instrumente Muzikore	14	9	7	2	5	6.5	77
20	Kimi	16	14	10	4	2	6.3	71
21	Matematikë	37	28	23	5	9	6.6	82
22	Matematikë-Fizikë	16	13	4	9	3	4.4	31

23	Matematikë-Informatikë	51	42	20	22	9	5.4	48
24	Shkenca Sociale	49	32	21	11	17	5.9	68

Nga Raportimi e të dhënave, **80%** e tyre e japin këtë provim **për herë të parë**, kurse pjesa tjetër për **herë të dytë 8.8%**, **të tretë 5.6%**, **të gjashtë 0.9%** dhe **të shtatë 0.1%**. Nisur nga kërkesa për dhënien e provimit vihet re se:

Përqindjen më të lartë të aplikimeve i kanë profilet si më poshtë:

o 19% e kandidatëve janë të profilit **"Arsim Fillor"**

o 11.2% e kandidatëve janë të profilit **"Gjuhë Shqipe dhe Letërsi"**

**Nga Raportimi e rezultateve, vihet re se:**

o **79.4%** e kandidatëve të regjistruar **marrin pjesë në provim**

o **53.5%** e këtyre kandidatëve **janë kalues**

Mbetet problem përqindja e ulët e kalueshmërisë së kandidatëve në provimin e shtetit. Gjykojmë se faktorë ndikues në këtë nivel të ulët kalueshmërie janë:

Përgatitja e tyre e ulët nga Universitetet ku kanë studiuar.

Përkushtimi i tyre në ndjekjen me korrektesë të praktikës profesionale.

Për këtë DRAP Durrës në bashkëpunim me ZVAP e varësisë do të monitorojë procesin e organizimit dhe ndjekjes së praktikës profesionale.

## **OBJEKTIVI I DYTË**

### **ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSUESVE**



### *Veprimtaritë për realizimin e objektivit*

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i punonjësve arsimorë orientohet dhe rregullohet me dokumentet: ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, 2014-2020; udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”; raporti “Identifikimi i nevojave për trajnim të mësuesve dhe të drejtuesve”; urdhri “Për ngritjen e komisionit të akreditimit të programeve të trajnimit”, i ndryshuar. Në legjislacion theksohet se mësuesit dhe drejtuesit trajnohen të paktën 3 ditë në vit dhe se trajnimet zhvillohen sipas sistemit “kërkesë - ofertë”, në bazë të nevojave të mësuesve dhe të ofertave nga agjenci trajnuese të akredituara.

Në kuadër të zhvillimit profesional të mësuesve janë ngritur rrjetet profesionale të mësuesve sipas profileve përkatëse apo sipas roleve të mësuesve në shkollë. Fuqizimi i rrjeteve profesionale të mësuesve ka qenë në vëmendje të veçantë të punës sonë në bashkëpunim të ngushtë me ASCAP-in në procesin e zbatimit të kurrikulës me bazë kompetencat. Rrjetet profesionale të mësuesve për çdo lëndë janë furnizuar në mënyrë të vazhdueshme me materiale mbështetëse, shoqëruar me takime dhe trajnime për zbatimin e tyre.

## **KUALIFIKIMI I MËSUESIT 2021-2022**

### *Pjesëmarrja e mësuesve dhe rezultatet*


Zhvillimi profesional i mësuesve është një nga detyrat themelore të punës për DRAP Durrës, Në bashkëpunim me ASCAP dhe ZVAP është organizuar puna për realizimin e procesit të kualifikimit të mësuesve për vitin 2021-2022, duke u ngritur grupet e punës dhe duke u orientuar të gjitha ZVAP për të vlerësuar me korrektësi portofolin personal dhe profesional të mësuesve. Kualifikimi i mësuesve për vitin 2022 u mbështet në Udhëzimin udhëzimit nr.4 datë 26.02.2021 “ Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve. Monitoruam me urdhër dhe platformë monitorimi ZVAP Tiranë, Vorë, Mat, Durrës, Krujë. Nga kontrolli i dosjeve me kampionim në secilën prej zyrave rezulton se janë zbatuar përcaktimet sipas udhëzimit përkatës. Janë konstatuar disa gabime në pjesën e përfitimit të bonuseve gjuhë e huaj dhe master

passhkollimi për të cilat në bashkëpunim me institucionet përkatëse eprore dhe të varësisë janë marrë masa që të korrighohen në kohë gabimet e konstatuara.


Numri i mësuesve të DRAP Durrës që morën pjesë në kualifikim është 1033 kandidatë dhe numri i mësuesve të cilët u futën në kualifikim ishte 960 kandidatë Tabela e mëposhtme pasqyron rezultatet për çdo zvap për të gjitha profilet.

Pjesëmarrje më të madhe kanë mësuesit që japin mësim në nivelin e arsimit **bazë në AMU**.

NR	ZVAP në varësi	Nr. i mësuesve pjesëmarrës	Lëndët																												Akron	Përshl			
			AF	APS	AS	B	E	PA	EFIZ	MUZ	F	Q	S	FL	P	GJ	GJA	GJF	GJ	GJI	SHL	H	K	M	TIK	BA	M	MUZ	SK	SK					
1	Bulqizë	24	8	1		3			1		1			1	1	3				1	1	3												AF	Arsini
2	Dibër	34	3	4		4			2		2				2	5			1	6	5												AP	Arsini	
3	Durrës	162	34	12		8		2	19		5	1	1		12	17	4		3	14	10	2	12	1		1	4					APSH	Arsini		
4	Kamëz	74	16	3		6			6		5				1	8	1	1		13	4	2	8									AS	Arsini		
5	Kavajë	35	5	5					1		0	1			5	3	2			7	2		4									B	Biologji		
6	Klos	15	3	2					1		0				1	0			1	5	1	1	1									E	Ekonomi		
7	Krujë	49	5	7		1			6		1				4	5	1			7	2	6	4									PAM	Art Pa		
8	Mat	14	3	0		0			2		1				1	1				3	1	1	1									EFIZ	Edukim		
9	Rrogzhinë	26	6	0		4			1		0		1		1	3				3	4		3									MUZ	Muzikë		
10	Shijak	17	7	2		0			1		0				3	2	8			1			1									F	Fizikë		
11	Tiranë	492	87	53	7	15	1	8	49	9	18	5	1		19	49	1	2	11	62	24	13	35	1	2	2	2					Q	Qyteta		
12	Vorë	18	3	0		1			1						3	4				4			1									S	Sociok		
